



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201602107/2

Tiranë ___/___/2016

Lënda : *Rekomandim për likuidimin e shpronësimit të pronës të shtetasit S.L, në zbatim të VKM-së nr.752, datë 5.9.2013 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit "Bulevardi verior dhe Rehabilitimi i Lumit të Tiranës", faza I, në Bashkinë e Tiranës"*

Drejtuar : Kryetarit të Bashkisë
Z. Erion VELIAJ

TIRANË

I nderuar z. Kryetar,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesën e tij shtetasi S.L, me banim në Tiranë, në të cilën ka shprehur shqetësimin në lidhje me zvarritje në procedurat e kompesimit për efekt shpronësimi të pasurisë me sipërfaqe 3000 m² truall dhe 3 godina (ku njëra prej tyre shtëpi banimi) në pronësi të tij, të prekura nga zbatimi i projektit "Bulevardi verior dhe Rehabilitimi i Lumit të Tiranës", faza I", në favor të Bashkisë Tiranë.

Ankuesi shprehet se, në kuadër të zbatimit të këtij projekti publik pasuritë e tij janë përfshirë në listën e subjekteve të konfirmuara nga ZVRPP Tiranë, si prona të cilat do të kompesohen për efekt shpronësimi në bazë të VKM-së nr.752, datë 5.9.2013 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit "Bulevardi verior dhe Rehabilitimi i Lumit të Tiranës", faza I, në Bashkinë e Tiranës". Kanë kaluar 3(tre) vjet nga kryerja e procedurave të shpronësimit për interes publik të pasurive të tij dhe nga vlera e miratuar për kompesimin e pronës, subjektit është likuiduar vetëm me 5% e shumës të akorduar.

Në këto kushte, subjekti ankues është drejtuar së fundmi organit Bashkia Tiranë me kërkesë nr.prot.S-21643, datë 04.10.2016 për likuidimin e plotë të

shpronësimit të pronës, pasi ZVRPP Tiranë ka bërë bërë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Bashkisë së Tiranës brënda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, ndërkohë që subjekti nuk ka tërhequr as minimumin e vlerës të kompesimit të shpronësimit të miratuar me VKM nr.752, datë 5.9.2013 nga organi i parashikuar në këtë akt nënligjor për përballimin e vlerës të plotë të shpronësimit, konkretisht Bashkia Tiranë.

Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Bashkia Tiranë, në përgjigjen e saj me shkresë Nr.prot. S-21645/1, datë 18.10.2016 drejtuar subjektit kërkues, ka sqaruar se: *“Bashkia Tiranë, për shkak të detyrimeve të lindura dhe të akumuluar gjatë viteve të fundit, nuk ka patur mundësi të shlyejë gjatë një viti buxhetor të gjitha detyrimet e prapambetura dhe të akumuluar në vite. Jemi duke e trajtuar me prioritet çështjen e financimit të shpronësimeve për këtë projekt, ku ndër të tjera jemi në diskutim me qeverisjen qendrore, për të parë mundësitë e financimit të mëtejshëm...”*.

Sa më sipër, ankuesi ka kërkuar ndërhyrjen e institucionit të Avokatit të Popullit për shqyrtimin dhe verifikimin e kësaj çështjeje me qëllim ndërmjetësimin pranë organit të Bashkisë Tiranë për vlerësimin e shqetësimit të ngritur dhe zgjidhjen sa më parë të çështjes të kompesimit të tij për efekt shpronësimi për interesa publikë.

Institucioni i Avokati i Popullit, pasi u njoh me ankesën dhe objektin e saj, si dhe nisur nga konkluzioni i sipërcituar në përgjigjen e shkresës tuaj me Nr.prot. S-21645/1, datë 18.10.2016, konstaton se, shkak i mos likujdimit të shpronësimit subjektit ankues nuk ka ardhur për shkaqe teknike apo për mungesë të akteve ligjore dhe nënligjore për këtë qëllim, por për mungesën e fondeve financiare që i nevojiten organit tuaj për kompesimin e subjekteve të shpronësuara, gjë e cila nuk përbën një shkak të ligjshëm për justifikimin e zvarritjes të këtij procesi të rregullt ligjor. Gjithashtu në përgjigjen tuaj, nuk gjejmë të parashikuar asnjë afat kohor, se për sa kohë i nevojitet organit tuaj që të kryejë likujdimin e plotë të subjektit të shpronësuar.

Avokati i Popullit referuar kërkesave të Ligjit Nr.8561, datë 22.12.1999 *“Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”*, thekson se ligji krahas procedurave që duhet të ndiqen dhe afateve që duhen respektuar për shpronësimin, parashikohet edhe përfundimi i procedurave të kompesimit të subjekteve, pronat e të cilave preken nga zbatimi i projekteve për interesa publikë dhe më pas fillimin e punimeve në pronat private, detyrim i cili nuk është respektuar nga organi juaj, Bashkia Tiranë, si subjekti në favor të të cilit është bërë shpronësimi i subjekteve.

Në këtë kuadër, vlen të përmëndim faktin se nisur nga rasti i lartëpërmendur, por dhe nga praktikat e deritanishme në Institucionin e Avokatit të Popullit me objekt shpronësimin për interesa publik, kemi konstatuar raste që përpara

fillimit të procedurave të shpronësimit dhe kompesimit të subjekteve, fillohet me punimet publike duke përbërë kështu një cënim të të drejtave të pronësisë të pronarëve.

Në këtë situatë, Avokati i Popullit konstaton se, kërkesa e pronarit të ligjshëm të shpronësuar z. S.L, është legjitime pasi Bashkia Tiranë me veprimet dhe mosveprimet e saj është bërë shkak që të zvarritet kompesimi në vlerën e shpronësimit për një kohë prej 3 (tre) vjetësh nga data e miratimit të VKM-së, duke i cënuar atij në vazhdimësi të drejtat themelore të parashikuara në nenin 41 dhe 42 të Kushtetutës së RSH. Konkretisht, në nenin 41/4 të Kushtetutës të RSH thuhet shprehimisht se: *“...Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrajt një shpërblimi të drejtë.*

Përveç kësaj, vonesa e krijuar në likuidimin e subjektit të shpronësuar nga ana e organit tuaj, mund të interpretohet ligjërisht edhe në formën e dëmit të shkaktuar dhe fitimit të munguar mbi pronën e ankuesit, në rast se subjekti do t'i drejtohet gjykatës, referuar nenit 44 i Kushtetutës, në të cilën parashikohet se: *“Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore”.*

E drejta e shtetasve për shpronësim, parashikohet edhe në Nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Europiane të Drejtave të Njeriut, ku ndër të tjera thuhet se: *“Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare”.*

Avokati i Popullit, bazuar në dispozitat Kushtetuese dhe në Ligjin Nr.8561, datë 22.12.1999 *“Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”*, konkretisht në nenin 3 të tij ku thuhet se: *“Shpronësimi dhe marrja në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private realizohet në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në këtë ligj, duke garantuar transparencën, barazinë e shtetasve dhe mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të tyre pasurore”*, sugjeron se, mënyra e garantimit dhe mbrojtjes të së drejtave të pronësisë në favor të shtetasit S.L, duhet të zhvillohet përmes një procedure të rregullt ligjore shpronësimi, duke patur parasysh likuidimin e plotë për vlerën e shpronësimit të subjektit, si edhe përcaktimin e një afati përmbyllës së këtij procesi brenda një kohe sa më të shkurtër dhe të arsyeshme, si pjesë e një procesi të rregullt administrativ. Konkluzioni i përmëndur në përgjigjen tuaj drejtuar subjektit ankues se, jemi duke e trajtuar me prioritet çështjen e financimit të shpronësimeve për këtë projekt, është e pamjaftueshëm dhe në shkelje e të së drejtës Kushtetuese dhe ligjore të subjektit të shpronësuar.

Referuar pikës 3, të VKM-së nr.752, datë 5.9.2013 ku thuhet se: “... *Vlera e plotë e shpronësimit prej 1 757 476 521 (një miliard e shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e njëzet e një) lekësh, do të përballohet nga Bashkia e Tiranës...*”, nënkupton se është në tagrin e organit ekzekutivë dhe atij vendimarrës Bashkia Tiranë, që të vendosë një afat të arsyeshëm për kryerjen e likuidimit të plotë për likuidimin e shpronësimit të pronës, konform legjislacionit në fuqi dhe Konventës Europiane të Drejtave të Njeriut.

Në përfundim, Avokati i Popullit thekson se, kryerja e ndërtimit të veprave me interes të lartë publik, që ndikojnë në rritjen e cilësisë së jetës të qytetarëve, janë për tu vlerësuar dhe mbështetur nga ana jonë, por ato duhet të ecin paralelisht me zbatimin korrekt të ligjit, në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit.

Në të tilla kushte, duke qenë se masa e likuidimit të shpronësimit të pronës të shtetasit S.L është në kufijtë minimal të 5% të vlerës të akorduar, ndërkohë që vijnë punimet për zbatimin e projektit “*Bulevardi verior dhe Rehabilitimi i Lumit të Tiranës, faza I*”, Avokati i Popullit fton organet vendimarrëse të Bashkisë Tiranë, për respektimin dhe zbatimin rigoroz të dispozitave kushtetuese dhe ligjore në marrëdhënie me individët dhe me të drejtat e pronësisë që ata gëzojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 21/b, të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, në të cilët thuhet shprehimisht se: “*Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit....., paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”, si për të gjitha arsyet e lartëpërmendura:

REKOMANDOJMË:

1. Respektimin e dispozitave ligjore të procedurave të shpronësimit për interesa publike, duke përfshirë edhe likuidimin e plotë të shpronësimit të pronës, në favor të shtetasit Z. S.L, në bazë të VKM-së nr.752, datë 5.9.2013 “*Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit "Bulevardi verior dhe Rehabilitimi i Lumit të Tiranës", faza I, në Bashkinë e Tiranës*”;

2. Shmangien e procedurave të parregullta apo të pabazuara në ligj, të cilat çënojnë të drejtat dhe interesat e ligjshme të subjektit ankues, duke vendosur

një afat të arsyeshëm kohor deri në likuidimin e plotë të subjektit të shpronësuar për interesa publik.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 date 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se: “*Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit*”, lutemi të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

Përgjigja duhet të përmbajë shpjegime të arsyetuara për çështjen në fjalë, si dhe masat që do të ndërmarren nga ana juaj, për zgjidhjen përfundimtare të problemit të trajtuar në këtë rekomandim.

Duke besuar në bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI